



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 3, datë 16.04.2024

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 18.05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 16.04.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kyetare! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës.

Kjo mbledhje, është kërkuar, nga Kryetarja e Bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren të bëj prezencën.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka ... Prezent.....deri tek.... Florian Tahiri...Prezent.

37 Këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.
Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MARS 2024
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” ZOTIT MIRUSH KABASHI (PAS VDEKJES)
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 475, DATË 23.12.2017 “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË RI TË ADRESAVE TË BASHKISË DURRËS”, I NDRYSHUAR.

Ka ndonjë koment për rendin e ditës?

Nuk ka.

Kush është dakord?

Kundra

Abstenim ...nuk ka.

Atëhere, me 37 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë **në pikën 1**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit z.Tahiri.

Florian Tahiri: Përshëndetje !

Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit u mbledh për të shqyrtuar pikën 1 të rendit të ditës dhe padiskutim që ramë dakord që të kaloj në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 1 ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? Nuk ka.

Atëhere, me 37 vota pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Denisa Luarasi

Denisa Luarasi : Përshëndetje Kryetar !

Edhe komisioni ynë ra dakord për të kaluar pikën 2 të rendit të ditës nisur nga kërkesa e ardhur nga Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”, për dhënien e titullit “Qytetar Nderi ” aktorit **Mirush Kabashi (Pas vdekjes)** me motivacionin : *“Personalitet i lartë dhe i shquar në fushën e artit, kulturës, edukimit, politikave kulturore, qytetar model, artist i madh i kinematografisë, skenës dhe ekranit”*.

Ju ftoj të votojmë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 2?

Dritan Burgjia : Mund t’i them dy fjalë ?

Ani Dyrmishi: Po z. Burgjia.

Dritan Burgjia : Natyrisht që ndjehemi të nderuar që na vjen rasti që të bëjmë këtë lloj vlerësimi për një figurë si Mirush Kabashi, kollosi i teatrit dhe kinemasë kombëtare. Unë do numëroja qindra role në teatër dhe kinema të Mirushit, qindra tituj dhe qindra çmime e dhjetra tituj.

Një koment do të kisha që, marr shkas dhe nga titulli që i dhamë z. Xhevdet Ferri, të kemi parasysht që këto tituj personazhe si Mirushi apo Xhevdeti t’i shijojmë vetë. Të kemi parasysht që t’i japim këto tituj kur ata janë gjallë.

Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? Nuk ka.

Atëhere, me 37 vota pro miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 3**. Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Denisa Luarasi

Denisa Luarasi : Po, edhe për pikën 3 komisioni ra dakord për votimin në lidhje me propozimin nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës në shenjë mirënjohje rruga në lagjjen 2 të marri emrin e Dëshmorit të Atdheut “Artan Cuku”. Kjo rrugë është degëzim i rrugës “Karl Topia”. Si dhe propozimi dytë në lidhje me emërtimin e një rruge, degëzim i rrugës “Sefer Efendi” me emërtimin rruga “Kastriot Aliaj”.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 3 ka?

Ardian Muka : Po. Thjesht një pyetje kisha.

Aktualisht këto rrugë që emërohen janë rrugë të reja apo ka pas një emër dhe është ndryshuar?

Emiriana Sako : Janë degëzime të rrugëve të caktuara.

Ardian Muka: Pra nuk kanë pasur një emër më përpara?

Emiriana Sako : Pra, në të gjitha rastet kemi tendencën që të gjejmë një aks i cili nuk do duhet të bëjë kompromis për të hequr një emër të caktuar, por vendosim aty ku kemi hapësirë.

Ani Dyrmishi: Koment tjetër?

Nuk ka. Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3?

Kundra? ... Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Atëhere, me 37 vota pro miratohet pika 3.

Ani Dyrmishi: Kryetare do të marrësh fjalën?

Emiriana Sako : Jo, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Do të njoftoheni për mbledhjen e ardhshme.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 4 (katër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Socialiste :

ROLANT XHELILAJ

Kryetar i Gr. Partisë Agrare Ambientaliste:

RENALD KOKA

